

**VIRION GRAÇI****POLEMISTË TË RINJ BASHKËKOHORË - MODELE TË  
TEJKALUARA POLEMIKASH**

*Shkëlqimi dhe degradimi i diskursit kulturor-letrar në periodikët “Fjala”, (gusht 2001- prill 2006) dhe “ARS” (31 mars 2002-6 gusht 2006)*

Vitet nëntëdhjetë të shekullit të kaluar e gjetën Shqipërinë në kaos të përgjithshëm. Rënia e strukturave shtetërore, atakimi i furishëm i institucioneve të shtetit totalitar, kompromentimi politik i autoriteteve të dalluara si *artistë, letrarë, kritikë e historianë të letërsisë*, indoktrinimi atomik i enteve ekzistuese botuese në fushën e librit artistik dhe periodikëve letrarë – kulturorë, e çoi orën kulturore dhe skenën letrare shqiptare në *një pikë zero*. Dy ishin, deri në atë kohë, periodikët kushtuar problemeve të letërsisë, artit, kulturës: revista *Nëntori* dhe gazeta *Drita*. Periodiku *Nëntori*, pushoi së qeni bashkë me sistemin shtetëror monist. *Nëntori* (emri vinte nga nëntori i Partisë Komuniste me datat e saj të shënuara) doli pa zhurmë nga tregu dhe vëmendja e lexuesve, vendin e tij e zuri revista voluminoze *Bota letrare*. Në shkrimin përshëndetës Dritëro Agolli, ende zyrtar i lartë, shprehet: “Vendimi i sekretariatit të KQ të Partisë për miratimin e botimit të revistës *Bota letrare* i gëzoi të gjithë njerëzit e kulturës dhe mbarë lexuesit tanë të etur për dituri... (shkurt V.G) urojmë që të mos mbetet mëhallë letrare...”<sup>1</sup>. *Bota letrare*, megjithëse promovoi me profesionalizëm autorë, vepra e dukuri të spikatura në kulturën perëndimore, pati jetëgjatësi të shkurtër, vetëm dy numra (Anëtarët e redaksisë u shpërndanë për të qenë protagonistë partiakë në skenën e re politike...). E kësaj periudhe, e gati me të njëjtën jetëgjatësi ishte dhe gazeta letrare E PËR7ME, botim studentësh, nxitur nga Agron Rexha, që përzgjidhte në fillimet letrare të autorëve pretendues si E. Hatibi, R. Zekthi, D. Xhelo, I. Belliu, A. Tufa, V. Graçi etj. Mbështetja e botimit u ndërpre dhunshëm, shpërndarja e kësaj gazete letrare antikonformiste nuk u mor më përsipër nga ndërmarrjet përkatëse të shpërndarjes së librave dhe shtypit ditor. Kështu, vëmendja dhe lexuesit u rikthyen te gazeta dhjetëra vjeçare *Drita*. Për shkak të ndërrimit të kursit të saj politik, por dhe për shkak të hapjes mirëprirëse ndaj asaj, që ishte më parë e ndaluar me ligj: kultura e mirëfilltë perëndimore, *Drita* mundi të rezistojë në tregun e mbipopulluar të shtypit duke mbajtur rreth vetes një numër të mirë lexuesish, deri sa, në vitet 1995-

---

<sup>1</sup> *Bota letrare*, nr. 1, janar 1991, f. 7.

96, fillon të humbasë ndjeshëm standardet në përzgjedhjen e teksteve të botuara, e, bashkë me rënien e standardeve humbet autoritetin dhe lexuesit duke dalë praktikisht nga qarkullimi.

Rolin që loznin deri në këtë kohë periodikët jetëshkurtër dhe *Drita*: letërsi e autorëve të rinj, autorë të ndaluar shqiptarë; përkthime nga letërsia botërore (tregime, poezi, memuaristikë, eseistikë), recensione letrare, sprova studimore, debate teoriko – estetike, u përpoqën ta kryejnë shtojcat letrare të gazetave të pavarura: *Koha jonë* me suplementin AKS (Art, Kulturë, Sport), *Gazeta shqiptare* me suplementin *Milosao*, si dhe gazetat e mirëfillta partiake: *RD* (e Partisë Demokratike), *ZP* (e Partisë Socialiste), *Republika* (e Partisë Republikane), me faqe të posaçme kushtuar letërsisë dhe problemeve të saj. Viti '97, me ashpërsimin e luftës së brendshme politike deri në përmasat e një lufte të armatosur civile, për lexuesin masiv zhvlerësoi moralisht vetë shtypin e shkruar, në tërësi, ndërkohë që ky i fundit përjashton nga tryeza e tij e lëndës përbërësin kulturor-letrar-artistik.

Nga kjo periudhë afërsisht, janar '97 dalin në dritë periodikët “Aleph” dhe “Mehr Light”, të dyja të konceptuara si revista letrare voluminoze, realisht të distancuara nga probleme të politikës ditore. Në to ka mbizotëruar lënda e përkthyer: poezi, eseistikë, fragmente romanesh, pjesë të zgjedhura nga mendimi filozofiko-letrar botëror. Kanë qenë të pranishëm dhe autorë shqiptarë të gjeneratave të ndryshme, kryesisht me krijimtari të re letrare duke iu shmangur debateve tipike të tranzicionit.

Duhet të mbyllet shek. XX që Shqipëria të ketë dy periodikë kushtuar tërësisht letërsisë artistike dhe problemeve, dukurive bashkëvajtëse me të. *Fjala* (gusht 2001 - prill 2006) dhe *Ars* (mars 2002 - gusht 2006). Prej tetë-nëntë vitesh, praktikisht në Shqipëri nuk më asnjë periodik kulturor-letrar.

### **Tipologjitë shkrimore te *Fjala* dhe *Ars***

Në *Fjala* dhe *Ars* gjejmë hapësirë gjithë zhanret letrare (poezi, tregime, pjesë romanesh, prozë poetike, epigrama, etj.), intervista, anketa, artikuj të mirëfilltë shkencorë, recensione, kritikë, eseistikë, pjesë antologjike nga mendimi humanist shqiptar i traditës, portrete shkrimtarësh e filozofësh botërorë; ka shkrime promovuese edhe nga fusha e historisë, nga antropologjia, arkeologjia, sociologjia, etj. Më e plotë në këtë gamë tekstesh është *Fjala*. Në të nuk mungojnë trajtesa të arrira në formën klasike të shkrimit akademik - shkencor nga A. Tufa, Dh. Shehri, L. Boçi, M. Krasniqi, A. Fuga, A. Aliu, B. Capriqi, G. Zela, O. Velaj, M. Haxhia, etj., etj. Shkrimet e këtyre autorëve, të promovuara në faqet e *Fjalës* do të jenë më vonë pjesë integrale në monografitë shkencore përkatëse. Në rubrikat e debateve, opinioneve, interpretime kulturologjike do të përfshihen e do të japin ndihmesat e tyre të patjetërsueshme pothuaj gjithë emrat domethënës të

hapësirës shqiptare, duke filluar që nga arkiva e traditës së çmuar me emra si Camaj, Maloki, Koliqi, Pipa, etj., duke vazhduar me autorë bashkëkohorë. Peshën më të madhe në këtë periodik e ka mbajtur themeluesi dhe kryeredaktori i saj A. Tufa. Ai është po ashtu autor i dhjetëra artikujve dhe shkrimeve me rëndësi thelbësore në kulturën tonë sot.

### Problematika

Nëpër editorialët, polemikat, temat e shpallura për diskutime e anketa, problematika vërtitet në pika të njëjta, si për shembull: letërsia shqipe dhe identiteti i saj; çfarë ishte letërsia në diktaturë dhe çfarë është letërsia shqipe sot?; çfarë është shkrimtari, vepra letrare, misioni i saj në shoqëri; letërsia zyrtare dhe letërsia e ndaluar, e të tjera pikëpyetje të tilla, të ricikluara e të përditësuara rëndom në mjedise letrarësh e teoricienësh të letërsisë, jo vetëm ndër ne shqiptarët. Krahas mendimit të shëndoshë, origjinal, shpërfaqur në këto periodikë me një gjuhë korrekte në planin etik-profesional, evidentohen shpesh modele shkrimore, të cilat fatkeqësisht kanë synuar të jenë imponuese, opinion bërëse, mbizotëruese, por jo me standarde cilësore për t'u pasur si modele pozitive. Defektet konceptuale apo prirjet ironizuese deri në sarkazëm vihen re në shumicën e titujve: “Shkrimtarët” pa misionarizëm ose “Kompleksi i kopilit”<sup>2</sup>; “Pse nuk ekzistojnë lexuesit shqiptarë?”<sup>3</sup>, “*Kultura zyrtare*” shqiptare është një kulturë që ushqehet me kufoma...”<sup>4</sup>, ...etj. Të ekzagjeruara, me theksime të pamerituara sarkastike janë disa polemika të kryera te *Fjala*: A. Tufa dhe V. Graçi kundër njëri-tjetrit; Balil Gjini dhe Edmond Tupe, kundër njëri-tjetrit, ndonëse bashkëpunëtorë aktivë të së njëjtës gazetë; grupi i shtojcës letrare *Milosao* kundër A. Tufës, V. Graçit dhe anasjelltas, etj. Më të ashpra dhe denigruese bëhen debatet kur është fjala për autorë e vepra të realizmit socialist duke iu rezevervuar këtyre një kënd të posaçëm ribotimi të quajtur *çipi i palaçove* (te *Fjala*). Groteskut, satanizimit të skajshëm i nënshtrohen reciprokisht te periodikët letrarë dhe në faqet letrare të shtypit të përditshëm autorë të ndryshëm, të çdo moshe e të çdo kualiteti artistik; ka grupime jo parimore, sektarizëm. Nga shembujt tipikë të debatit në distancë është skica satirike e A. Tufës titulluar: *Është gjallë apo ka vdekur?* Me nëntitull: *Ky nuk është Shpëtim Kelmendi!*<sup>5</sup> E përmbledhur në pak fjalë:

<sup>2</sup> *Fjala*, 23-30 janar, 2005, A. Tufa.

<sup>3</sup> Po atje, M. Krasniqi.

<sup>4</sup> *Ars*, 30 maj, 2004, f. 10.

<sup>5</sup> *Fjala*, 14-20 korrik 2003, f. 3. A. Tufa shkruan: se kush është një pseudonim, një rishtar i vonuar i shkrimtarisë që maskohet me emrin Shpëtim Kelmendi. Na shtrëngoi të interesohemi zukatja e bezdisshme që përhap ky pseudonim në gazetën “Albania”. Duke zënë hundët me dorë i marr paksa erë kësaj mize plehu që të di si ta

autorët të cilët me krijimtarinë e tyre i kanë dhënë fizionomi të re letrare dhe përmbajtje origjinale artistike *Fjalës*, në rastet kur kanë polemizuar, kanë treguar mungesë të theksuar respekti dhe principialiteti për mendimin ndryshe, si dhe për kolegët e “grupit” tjetër.

*Ars* (kryeredaktor Irhan Jubica) është e organizuar ngjashëm me *Fjala* në rubrikat: Debat, Krijimtari, Ekskluzive, Ese e Kritikë. Ndryshe nga *Fjala*, e cila në fushën e mendimit letrar ka për bosht kryesor shkrimet origjinale dhe përkthimet e kryeredaktorit, *Ars* ka disa bashkëpunëtorë të përhershëm, të cilët e pasurojnë fizionominë e saj me larmi stilesh. *Ars*, për sa iu përket editorialëve, pra, *kryeshkrimeve-opinion*, dallohet se është gazetë redaksie, produkt autorësh e bashkëpunimi më të gjerë. Secili nga autorët arrin të krijojë një profil të tijin, të dallueshëm te *Ars* (te *Fjala*, për shembull, autorët debutues, nga shkrimi në shkrim binin nën ndikimin e modeleve e autoriteteve që gjenin te gazeta ku shkruanin). Ridvan Dibra, bashkëpunëtor i rregullt në *Ars*, i letrarizon polemikat, i përgjithëson më mirë e më drejt problemet, dukuritë shqetësuese duke iu larguar emrave konkretë dhe satirës së personalizuar asgjësuese, duke anuar nga eseistika ose nga trillimi ilustrues artistik. Shembuj (te *Lojëra me pa të keq*):

“Edhe pse isha i ndërgegjshëm për veçantinë e kësaj vepre dhe vështirësitë që paraqiste receptsi i saj nga lexuesit dhe kritikët dembelë e tradicionalë, heshtja që mbështolli daljen e këtij romani më vrau e më dhambi jo pak...”<sup>6</sup>

“Desha të cik një problem të përgjithshëm, një dukuri (plagë) të mprehtë, nga e cila vuan jo pak letërsia shqipe, sidomos ajo e dekadës së fundit. E kam fjalën për kriteret e gjykimit e të vlerësimit. Për atë klimë të mbrapshtë amatorizmi, klanesh e paragjykimesh, që mbizotëron ndër “gjykatësit” e vlerave e të veprave, domethënë ndër studiuesit dhe kritikët tanë letrarë. E rëndësishme për ndoca specie sharlatanësh e spekulatorësh, snobësh e nihilistësh...(shkurt- V. G.) Mjerim.”<sup>7</sup>

Ardian Marashi bashkëpunëtor i rregullt i *Ars*, në rubrikën e tij krijon një profil të spikatur prej studiuesi profesionist dhe eseisti thumbues ndaj dukurive, jo ndaj personash të identifikuar. Ka trajtuar me sukses tema të qenësishme lidhur me letërsinë shqipe dhe europiane, nga hershmëria e saj deri te ballafaqimet, kryqëzimet, ndikimet e njëanshme dhe bashkëprania e tyre për lexuesit tanë në ditët tona. Vlen të sjellim nga *Ars* këtu disa fragmente ndihmesash nga A. Marashi: *Letërsia shqipe, një mozaik i krisur...*. Te mjaft

---

klasifikoj siç bënim në shkollë kur emërtonim në latinisht dëmtuesit e bimëve dhe sakaq ia gjej emrin e përshtatshëm: *mizus erë mutis...*

<sup>6</sup> *Ars*, e diel, 26 tetor, 2003, f. 21.

<sup>7</sup> Po atje...

shkrimtarë të Shqipërisë vihet re ajo që po e quajmë dukuria e negativitetit përzgjedhës: për shumicën sish, një koleg i përtëj kufirit është një koleg i denjë për interes, që zë një vend të caktuar në një klasifikim të jashtëshkruar, por kurrsesi një koleg që mund të krahasohet me të. Po marrim si shembull Martin Camajn: për shumë prej shokëve të mi letrarë Camaj mbahet si më i madhi shkrimtar shqiptar i diasporës, por si më i madh se vetja e tyre (shkurt. V. G.). Të mendosh pastaj se Dibra ka të drejtë kur thotë se provincializmi safi pikërisht në Tiranë është ulur këmbëturqisht. Ky provincializëm i Tiranës, më duket mua, përbën sot pengesën kryesore të integritetit të plotë e të suksesshëm mbarëshqiptar. Sepse, gjithmonë sipas meje, provinciali, në rastin më të mirë dhe mendje ligu, në rastin më të keq mendojnë se rivaliteti dhe konkurrenca i shterojnë mundësitë e suksesit personal. Kurse në fakt e kundërta vërehet rëndom: rivaliteti e konkurrenca e ndihmojnë njeriun punëtor të mbahet gjithnjë në kuotën e tij më të lartë, të japë në vijimësi maksimumin e potencialit të vet.”<sup>8</sup>

Model studimi krahasues, paraqitur me stilin e zhërvjellët të një eseisti të kultivuar nga A. Marashi kemi tekstin: *Nga Bodëleri te Camaj: poetika e palimpsestit...*

Shkrimtarë të njohur të ftuar në *Ars* të japin mendime për tema letrare, tregojnë maturi, vetëpërmbytje, korrektësi. Kështu shfaqet Vath Koreshi në: *Letërsia shqipe dhe identiteti i saj*; po kështu, pranueshëm, në parametra normalë të komunikimit publik, japin ndihmesat e tyre L. Stani, F. Myrtaj, T. Çobani, L. Topçiu, B. Baliu, A. Zeneli, N. Berishaj, A. N. Berisha, J. Neziraj, R. Elsie, etj. Kujtojmë se *Ars* e *Fjala* kanë të përbashkët një numër të madh autorësh, në rubrikat *Krijimtari* dhe te përkthimet nga letërsia e huaj.

Poeti dhe studiuesi Ramadan Musliu del rregullisht me opinione në *Ars*. Dëshmon përgatitjen e duhur për t'i trajtuar problemet, dukuritë, tekstet letrare në nivel profesional, por, në këtë periodik, në tekstet teoriko-interpretative, ndërfit vlerësime të skajshme pezhorative, të personalizuar, duke kompromentuar qëllimin e angazhimit të tij në debate. Shembull përmbledhës nga: “*Letërsia, pasqyrë e disintregimit të ndërgjegjes kulturore të kombit*”. R. Musliu verën se... e para – Letërsia shqipe nuk mund të kuptohet, që domethënë se letërsia shqipe është zhvilluar në qendra të ndryshme...; e dyta... letërsia aktuale në Shqipëri është viktimitë e klisheve të trashëguara nga ideologjia totalitare gjysmëshekullore. Estetika dhe autoriteti i kësaj letërsie sot mbështeten mbi këto klishe. Kjo është arsyeja pse sot rudimenti revolucionar i kulturës së masave të jetë konvertuar në tipin e kulturës masovike të llojit të spektaklit...; e treta... retushimi i letërsisë dhe i

<sup>8</sup> *Ars*, e diel, 26 tetor 2003, f. 3.

veprave të veçanta...; e katërta... fragmentarizimi i letërsisë për shkak të përzjerjes së politikës në letërsi dhe për shkak të monopolit dhe kontrollit që disa klane kanë mbi institucionet kulturore... dhe e pesta... përjashtimi i letërsive që janë krijuar jashtë shtetit, duke vazhduar tutorinë etatiste mbi kulturë ... qëndrim mohues ndaj shkrimtarëve në Kosovë duke botuar *shkrimtarë periferikë si A. Vinca, palaçollëqet poetike të Ali Podrimjes* në përpjesëtim me shërbesën që këta i bëjnë klaneve të caktuara në Tiranë...<sup>9</sup>. Cilësimet për Vincën dhe Podrimjen duket se janë larg realitetit, tingëllojnë qëllimshëm denigruese për të parin si krijues, për të dytin si krijues e si njeri.

Kampion në këtë lloj risie letrare të denigrimit të letërsisë dhe emrave të afirmuar në letërsi është Blendi Kraja. Një shkurtesë e shkrimit të tij: *çka të vjedhësh ndër periodikë shqiptarë: 1. Protestë e gjithanshme; 2. Panairi i oligarkive...; 3. Mediat e lagjes tironse...; 4. Një kosovar në Tiranë; 5. Ali Aliu-Cërrni; 6. Zgjimi i vonë i Kë-ve; 7. Lanksh: punë rasti, punë miqësie, punë lidhjes; 8. A do të kenë fund këto dukuri?..* Ky shkrim, sikurse shkrimet e tjera të tij në *Ars*, rrezaton një frymë nihilizmi çnjerëzor, çka bie ndesh në radhë të parë me vetë moton e punës së shpallur po prej tij dhe redaksisë botuese: *“arsi është përvijuar si një rrymë mendimi jo vetëm e ndryshme por edhe prodhuese vlerash të reja tjetërsoj nga ato që kanë ardhur nga e kaluara, e tjetërsoj nga ajo çka sot po shkarravitet ndër fletushka e të tjera gazeta pleqsh”*<sup>10</sup>.

Gilmana Bushati, tjetër bashkëpunëtore e rregullt e *Ars*, shfaq një formë më të përpunuar nihilizmi. Proceset letrare, letërsinë shqipe dhe autorët shqiptarë përpiqet t’i përjashtojë nga çdo formë diskutimi, vlerësimi a njohjeje duke i relativizuar mekanikisht me leximet e pretenduara të saj nga letërsia botërore. Në shkrimin: *Bashkëkohësia, një listë e zbehtë*, shprehet: “nuk mendoj se duhet të flitet për bashkëkohësi të letërsisë shqipe me letërsitë e tjera... (shkurt V. G.) nga vepra e çdo shkrimtari kërkoj të “harrohem” në tërësinë e saj. Kjo gjendje më ndodh shpesh por jo me veprat shqiptare.”<sup>11</sup> Të paktën, G. Bushati i shfrytëzon hapësirat e *Ars* për të nxjerrë në pah kozmopolitizmin e saj, hapjen mendore ndaj globales dhe mbylljen mendore-shpirtërore ndaj asaj që është shqiptare. Po në këtë linjë, te ballafaqimi i mendimeve për raportet imagjinare midis kombëtares dhe globales opinionisti Blendi Kraja, te shkrimi: *Sa e përbotshme është letërsia e sotme shqipe?* zhytet ndërgjegjshëm në krijimtari shpifëse, dezinformuese kur shkruan për autorë të identifikuar në publikun e gjerë me nga disa libra: “Europa – atdheu ynë i përbashkët – letërsia e tenderave ...rroftë avangarda! Asnjëri prej tyre nuk ka përfaqësuar ndonjëherë letërsinë e re shqiptare ...avangarda

<sup>9</sup> *Ars*, e diel 26 tetor 2003, f. 2.

<sup>10</sup> *Ars*, 30 nëntor 2003, f. 8-9.

<sup>11</sup> *Ars*, 30 maj 2004, f. 3.

pasqyrohet nga konviktorët që e popullonin Tiranën e fillimit të viteve '90: Rudian Zekthi, Ervin Hatibi, Virion Graçi, Gentian Coçoli, Rudi Erebara... (shkurt V.G.) ja çka qenë avangarda ndër këta konviktorë, që sipas kujtimeve të studentëve të atëhershëm ishin kthyer në problem të madh pastërtie, sepse as dëgjonin të qetheshin e të rruheshin, e as të laheshin a të ndërronin rrobat, e le më pastaj të pastronin rrobat a të prisnin thonjtë... Por ndoshta, këto vargje si pirgje plehrash që në dekompozim e sipër qelbin mëhallën, janë fytyra e vërtetë e avangardës së paqenë shqiptare të viteve nëntëdhjetë.”<sup>12</sup> B. Kraja te *Ars*, krahas letrarëve të përgojuar si më sipër, dezinformon për seminarin shkencor mbajtur në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, UT, me temë: *Fenomeni i avanguardës në letërsinë shqipe*. Sa për informacion korrekt rendisim autorët dhe temat e mbajtura në seminar: prof. S. Hamiti: *Avangarda dhe përshtatja*; dr. K. Jorgo: *Avangarda si provokim për historishkrimin e letërsisë shqiptare*; prof. F. Dado: *ç'ka duhet kritika?* - *Arshi Pipa në vitin 1944*; dr. R. Kryeziu: *Migjeni dhe avangarda*; dr. Dh. Shehri: *Elementë të shkrimit modern në prozën poetike të Koliqit*; prof. I. Shema: *Koncepte të avanguardës në letërsi*; prof. L. Matoshi: *Migjeni-poet i veçantë*; dr. A. Jakllari: *Tipare të avanguardës në romanin shqiptar të pas viteve '90*; mr. P. Asllani: *Në prapavijë të avanguardës*; K. Gjika: *Egocentrizmi si tipar i modernitetit në letërsinë e 900-ës së parë*; dr. L. Boçi: *Procedimet kohore në romanet modern të Camajt, Qoses dhe Pashkut*; prof. N. Islami: *Ide të avanguardizmit në letërsinë shqiptare të Kosovës – disa ide prijëse në romanin e R. Qosjes*; V. Osja: *Probleme të avanguardës dhe G. Pali si artist avanguardist*; prof. N. Sopaj: *Atipizmi në vitet '70 në letërsinë shqipe*; M. Marku: *Avanguardia e nëntëdhjetës*; L. Sula: *Një vështrim mbi historinë e receptimit të letërsisë së viteteve '30*; A. Tufa: *Aspekte kulturoro-filozofike nga tregimi “Lumi i madh” i Mitrush Kutelit*; prof. J. Papagjoni: *Sprova të modernizmit në rrjedhat e fundme të dramës shqipe*; mr. L. Smaçi: *Romani “Pse” në kërkim të disa përgjigjeve*; A. Mullaj: *Disa prurje simboliste në gjuhën shqipe*; prof. Y. Çiraku: *Poezia e gjysmës së dytë të shek. XX si hierarki vlerash*; dr. K. Petriti: *Veçori të ritmit dhe ndërtimit tekstor në poetikën e Camajt*; dr. B. Suta: *Koliqi dhe Migjeni në kuadrin e modernizmit të letërsisë shqipe të viteve '30*; E. Gjika: *Retiçensa si risi në tekstin e Lasgush Poradecit*; V. Graçi: *Risi në romanin shqiptar: “Dueli” A. Tufa*; prof. K. Kodra: *Dialogu në novelat e qytetit të veriut si shprehje e realizmit problematik të Migjenit*; mr. O. Gashi: *Dy skaje të prirjeve avangardiste: Lasgushi dhe Migjeni*.

Sikurse shihet nga pjesëmarrësit, nga titujt e kumtesave e referateve, nga botimi përmbledhës i materialeve të mbajtura në seminar, kemi të bëjmë

<sup>12</sup> *Ars*, 30 maj 2004, f. 3-4.

me një angazhim serioz, me një ngjarje të shënuar shkencore e cila, në çdo këndshikim nuk ka neglizhuar aspak kriteret rigoroze të trajtimit racional të dukurive e problemeve, prej bashkëkohësisë e deri në hulumtimin historiko-krahasues të llojeve të ndryshme letrare e të autorëve përfaqësues. Nga ana tjetër, në *Ars* kemi kronikën përqeshëse dhe kritikën e kësaj veprimtarie...

Të njëjtën qasje nihiliste, me përgjithësim aprioristike si B. Kraja, përdor dhe opinionisti tjetër i *Ars*-it, i paraqitur si *arbëreshi* Mario Bellizzi, jo vetëm në sprovën: “*Kultura zyrtare*” *shqiptare është një kulturë që ushqehet me kufoma...*<sup>13</sup>

Vërehet në përgjithësi se mënyra nihiliste të shkrimit kulturologjik si këto në *Fjala* dhe *Ars* nuk gjenden në shtypin shqiptar të traditës, në gjysmën e parë të shek. X. Fjalori i përdorur, lehtësia në ngritjen e akuzave dhe e argumenteve kundra pa asnjë bazë konkrete, mbështetëse, nuk u gjendet ngjashmëri as në pretendat politiko-policore të periudhës së diktaturës. Me fare pak përjashtime, autorët e kësaj breznie në *Fjala* e *Ars*, vlerat e mirëfillta vetjake si krijues letrarë, profilet krijuese serioze e premtuese si poetë, tregimtarë, romancierë, shqipëruues, dramaturgë me prurje të vazhdueshme cilësore, nuk i shfaqin aspak në debate, polemika, përkundrazi. Për këtë dukuri negative, dëmsjellëse kemi një interpretim nga Albert N. Nikolla, shkrimtar i dalluar i këtij brezi: “Gjenerata e vjetër e kritikëve dhe profesorëve asnjëherë nuk e ka marrë mundimin të lexojë veprat e gjeneratës së re... kritikët e rinj janë njëkohësisht krijues, profesora, etj. por ata janë aq egoistë në sistemin e tyre të të mneduarit dhe të të shkruarit... egoizmi krijues është kthyer në urrejtje ndaj “konkurrentëve”, gjë që ka prodhuar një zinxhir urrejtjeje të paimagjinueshme, që s’ka të bëjë aspak me letërsinë. Jemi përballë një refuzimi zinxhir të letërsisë së njëri-tjetrit. Do të duhet të kalojnë dekada që brezi pasardhës të bëjë seleksionimin e vlerave letrare të gjeneratës së sotme të shkrimtarëve. A ka shkrimtarë të mëdhenj gjenerata e sotme? Duhet të lexohen që të merret vesh e vërteta dhe shkrimtarët e rinj duhet të heqin dorë nga urrejtja ndaj njëri-tjetrit, pasi urrejtja është shkatërruese e shpirtit krijues të individit”<sup>14</sup>.

Si përfundim periodikë letrarë nuk kemi më; ...askush nuk i mbështet me financime botimi, honoraresh, shpërndarjeje letrarët, kritikët, promovuesit e letërsisë dhe të arteve në përgjithësi. Ka qenë e dobishme dhe e pakëndshme njëkohësisht ekzistenca e periodikëve letrarë, si *Fjala* dhe *Ars*, për shembull. Sot, mungesa e periodikëve letrarë në Shqipëri është nga faktorët kryesorë për shterpëzimin dhe deformimet e rënda në skenën letrare, në edukimin e

<sup>13</sup> *Ars*, 30 maj, 2004, f. 10.

<sup>14</sup> Albert N. Nikolla, nga faqja e tij në internet, postim i datës 10.06.12.

natyrshëm estetik të letrarëve të rinj dhe të lexuesit masiv përgjithësisht; është ndër faktorët kryesorë për ngecjen, ngrirjen në kohë të shkuara të shijes së lexuesve të sotëm. Mungesa e shtypit të specializuar për kulturën është shkak për heshtjen a paditurinë që shpesh rrethon ngjarje e personalitete nga bota e madhe kulturore; mungesa e periodikëve letrarë me standarde të mjaftueshme etiko-profesionale ka ndihmuar që hapësira publike të popullohet me pseudovlera, me pseudofigura të ardhura nga margjinat, pseudofigura të cilat makineritë abuzive të telepropagandës agresive ia shërbejnë vëmendjes së publikut të gjerë si gjenij letrarë, si super talente, si disidentë, si profetë, si korifej të emancipimit qytetar e intelektual, e të tjera e të tjera tituj e merita të pamerituara si këto.

## **BIBLIOGRAFI KRYESORE**

Periodiku *Fjala*; Periodiku *Ars*; Revista *Bota letrare*; Revista *Aleph*; Revista *Mehr light*; gazeta *Drita*.

## **SUMMARY**

### **NEW CONTEMPORARY POLEMISTS – OLD MODELS OF POLEMICS**

This paper aims to draw attention to some of the protagonists' polemics in the Albanian cultural and literary media after the restoration of freedom of thought and expression. The study will consider some of the cases of prominent controversies on literary and cultural matters not to affirm the model but to keep critical stance, distancing the benefit of a morality of the methodology acceptable intellectual and professional.

